



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranverorë

Kryesia e Kuvendit
P-026
Prishtinë, më 2 korrik 2008, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT TË MBAJTUR MË 2 KORRIK 2008

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Eqrem Kryeziu, Xhezair Murati dhe Sllobodan Petroviq, ndërsa mungoi Nexhat Daci;

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi dhe Sherif Konjufca ;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Ismet Hajrullahu;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala dhe

Nga NDA: Arben Kelmendi.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe katër pika të tjera.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtura më 24 qershor 2008,
2. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Integritim Evropian për lejimin e vizitës zyrtare në Parlamentin e Kroacisë,
3. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Integritim Evropian për lejimin e vizitës zyrtare në Kuvendin e Shqipërisë,
4. Shqyrtimi i kërkesës së Organit përzgjedhës për kompensimin e punës së tyre për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit.
5. Shqyrtimi i ftesës së Asamblesë Parlamentare e NATO-s për të marrë pjesë tre deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës në punimet e saj,
6. Shqyrtimi i kërkesës së Kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi, për tërheqjen e tri projektligjeve nga procedura e shqyrtimit.

7. Të ndryshme:

7.1 Njoftimi lidhur me nismën për formimin e Grupit joformal të deputetëve të rinj në moshë,

7.2 Kërkesa e Grupit Parlamentar të AKK-së.

7.3 Caktimi i pushimit vjetor për Kuvendin.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 24 qershor 2008

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtura më 24 qershor 2008, u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Integritim Evropian për lejimin e vizitës zyrtare në Parlamentin e Kroacisë

Anëtarët e Kryesisë diskutuan lidhur me kërkesat e deputetëve dhe të komisioneve parlamentare për lejimin e udhëtimeve jashtë vendit. Konstatim i përbashkët ishte se vizitat zyrtare për bashkëpunim ndërparlamentar duhet të vazhdojnë edhe në të ardhmen, por të reduktohet përbërja e delegacioneve - tre deri në pesë deputetë - që përfaqësojnë strukturën politike të Kuvendit.

Kryetari do të mbajë një mbledhje me kryetarët e komisioneve parlamentare, ndërsa Kryesia me kryetarët e grupeve parlamentare për të përcaktuar kriteret e udhëtimeve jashtë vendit, me qëllim të avancimit të bashkëpunimit ndërparlamentar dhe të racionalizimit të shpenzimeve.

Kryesia, edhe kësaj radhe, pasi shqyrtoi kërkesën e Komisionit për Integritim Evropian, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Komisionit për Integritet Evropian në Parlamentin e Kroacisë në këtë përbërje: Zylfije Hundozi, Bujar Bukoshi, Dzezair Murati, Hydajet Hyseni, Edita Tahiri, Sabri Hamiti, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Nait Hasani, Naser Rugova dhe Branislav Grbic, si dhe Ahtere Loxha nga stafi i Administratës, prej 09 deri më 11 korrik 2008.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit nga paragrafi një (1) të këtij vendimi përballohen nga organizatori - Fridrich Ebert Stiftung, ndërsa mëditjet nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr.02-2242-1/06.
3. **Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Integritet Evropian për lejimin e vizitës zyrtare në Kuvendin e Shqipërisë**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e Komisionit për Integritet Evropian, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Komisionit për Integritet Evropian në Kuvendin Republikës së Shqipërisë, në këtë përbërje: Zylfije Hundozi, Bujar Bukoshi, Dzezair Murati, Hydajet Hyseni, Edita Tahiri, Sabri Hamiti, Fatmir Rexhepi, Njomza Emini, Nait Hasani, Naser Rugova dhe Branislav Grbic, si dhe Minire Hasani nga stafi i Administratës, prej 14 deri më 16 korrik 2008.
2. Shpenzimet e qëndrimit nga paragrafi një (1) të këtij vendimi përballohen nga nikoqiri – Kuvendi i Shqipërisë, ndërsa udhëtimin dhe mëditjet i përballon Kuvendi i Kosovës, sipas vendimit të Kryesisë nr.02-2242-1/06.
4. **Shqyrtimi i ftesës së Asamblesë Parlamentare të NATO-s për të marrë pjesë tre deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës në punimet e saj**

Kryesia, pasi shqyrtoi ftesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet pjesëmarrja e deputetëve të Kuvendit të Kosovës: Skumbin Demaliaj, Memli Krasniqi dhe Radmila Vujoviq në punimet e Asamblesë Parlamentare të NATO-s, që mbahet në Bruksel, Belgjik, prej 14 deri më 17 korrik 2008.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit nga paragrafi një (1) të këtij vendimi përballohen nga organizatori, ndërsa mëditjet nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr.02-2242-1/06.
5. **Shqyrtimi i kërkesës së Organit përzgjedhës për kompensimit të punës së tyre për përzgjedhjen e anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Lejohet kompensimi i Organit të pavarur përzgjedhës në shumën prej 50€ për secilin anëtar, ndërsa 30€ për stafin mbështetës nga Administrata e Kuvendit për çdo mbledhje të mbajtur.
2. Kompensimi nga paragrafi një (1) i këtij vendimi të realizohet për çdo mbledhje, deri në përfundim të përzgjedhjes së kandidatëve për Organin Shqyrtues të Prokurimit, sipas vendimit të Kuvendit nr.03-0413/DO-130.

6. Shqyrtimi kërkesës së Kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi, për tërheqjen e tri projektligjeve nga procedura e shqyrtimit

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë me përmbajtjen e kërkesës së Kryeministrit të Kosovës, Hashim Thaçi, për tërheqjen e tri projektligjeve nga procedura e shqyrtimit.

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

1. Kryesia e Kuvendit mbështet kërkesën e Kryeministrit të Kosovës për tërheqjen e Projektligjit të punës dhe Projektligjin për statistikat zyrtare, që janë në shqyrtim e sipër në komisionet funksionale, si dhe të Projektligjit për sigurimet shëndetësore, i cili është miratuar në Kuvendin e Kosovës dhe i është dërguar PSSP-së për shpallje, por nuk e ka shpallur me arsyetimin se ka implikime buxhetore të papërballueshme.
2. Kërkohet nga komisionet funksionale, që i ka ngarkuar Kuvendi për shqyrtimin e projektligjeve të sipërpërmendura, që t'ia paraqesin Kuvendit rekomandimet në bazë të kërkesës së Qeverisë së Kosovës.

7. Të ndryshme:

7.1 Njoftimi lidhur me nismën për formimin e Grupit joformal të deputetëve të rinj në moshë

Kryesia, pasi u njoftua me nismën për formimin e Grupit joformal të deputetëve të rinj në moshë, nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Kryesia e Kuvendit nuk e pengon asnjë nismë për formimin e grupeve joformale, por nuk merr asnjë detyrim për mbështetjen e punës së tyre.

7.2 Kërkesa e Grupit Parlamentar të AAK-së

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë me përmbajtjen e kërkesës së Grupit Parlamentar të AAK-së, me të cilën është kërkuar nga Kryesia e Kuvendit që ky grup të trajtohet si grupi parlamentar i treti me radhë, në bazë të numrit të anëtarëve të tij.

Kryesia diskutoi lidhur me kërkesën e Grupit Parlamentar të AAK-së, por nuk vendosi për të, me arsyetimin se Rregullorja e Punës së Kuvendit është në hartim, në të cilën duhet të hartohen kriteret për formimin dhe funksionimin e grupeve parlamentare.

7.3 Caktimi i pushimit vjetor për Kuvendin

Kryetari tha se meqë jemi në sezonin e pushimeve vjetore Kryesia duhet ta caktojë kohën e pushimit vjetor për deputetët dhe stafin e Administratës së Kuvendit.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kohën e pushimit të Kuvendit, mori këtë

V E N D I M

Kuvendi, deputetët dhe stafi i Administratës, pushimin vjetor duhet ta shfrytëzojnë prej 1 deri më 31 gusht 2008.

Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 13:05 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

E hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale